

**FORUMI**  
për  
**SIGURI**

**Procesi i hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës**

*Gjithëpërfshirja dhe transparenca*

Prishtinë, maj 2013

# FORUMI për SIGURI

FORUMI PËR INICIATIVA QYTETARE (FIQ), INSTITUTI GAP, INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI (IKD), dhe INSTITUTI PËR POLITIKA ZHVILLIMORE (INDEP)

## **Mirënjohje**

Kjo analizë është shkruar nga Visar Rushiti nga Instituti GAP, anëtar i Forumit për Siguri (FS).

Punimi është realizuar me përkrahje të Ballkan Trust for Democracy (BTD).

## **© Të drejtat autoriale**

Asnjë pjesë nga ky publikim nuk mund të riprodhohet apo të ndryshohet pa lejen e botuesit.

Mendimet e shprehura me shkrim apo në publikimet elektronike janë të Forumit për Siguri dhe nuk përfaqësojnë pikëpamjet e donatorit.

## Përmbledhje ekzekutive

Procesi i hartimit të Strategjisë të Sigurisë së Kosovës nuk ka qenë gjithëpërfshirës, transparent, dhe strategjia nuk është bërë publike as pas miratimit. Madje, versioni final i strategjisë ishte imponuar nga Zyra Këshillëdhënëse për Siguri në kuadër të Zyrës Civile Ndërkombëtare. Prandaj, procesi i hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe transparent. Përveç institucioneve publike, në procesin e hartimit të strategjisë duhet të marrin pjesë shoqëria civile, mediat, ekspertë të pavarur të fushës, parti politike, dhe palë tjera të interesuara.

Vendimi 09/67 i Qeverisë së Kosovës (mars 2012) për miratimin e nismës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS) në Kosovë, përkatësisht pika 1.6 e tij, përcakton nxjerrjen e një Strategjie të re të Sigurisë së Kosovës. RSSS ka një strukturë organizative nën drejtimin e Komitetit Drejtues të cilin e udhëheq Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Nxjerrja e një Strategjie të re të Sigurisë bazuar në këtë vendim, përkatësisht pikën 1.6 është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, nenin 127 i cili përcakton se Këshilli i Sigurisë i Kosovës (KSK) në bashkëpunim me Presidentin dhe Qeverinë, nxjerrin Strategjinë e Sigurisë së Kosovës. Përveç kësaj, vendimi në fjalë është në kundërshtim edhe me Ligjin për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, përkatësisht nenin 2.1 i cili përcakton se Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në koordinim me Presidentin e Kosovës, përgatitë dhe shqyrton Strategjinë e Sigurisë e cila miratohet nga Qeveria dhe i dorëzohet Kuvendit të Kosovës për miratim përfundimtar.

Procesi i hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës duhet të fillojë pas përfundimit të procesit të RSSS-së. Nxjerrja e Strategjisë së Sigurisë së Kosovës dhe RSSS duhet të jenë procese të ndara. Inicimi i këtij procesi duhet të jetë i hapur dhe të merret vendim nga ana e Qeverisë, e cila në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet tjera, do të autorizonte Këshillin e Sigurisë së Kosovës që të koordinonte procesin e hartimit të saj. ShBA dhe Franca janë dy vende që përfaqësojnë shembuj të mirë të një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare.

Të gjitha vendet e regjionit dhe shumica e vendeve të Bashkimit Evropian (BE), bëjnë publike dokumente qoftë në formë të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare qoftë në formë të një dokumenti relevant për sigurinë dhe mbrojtjen e tij. Strategjia e Sigurisë Kombëtare nuk është dokument konfidencial dhe si i tillë bëhet publik. Prandaj, bazuar edhe në Ligjin për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë në Kosovë, Strategjia e Sigurisë së Kosovës do të duhej të jetë publike dhe lehtë e qasshme nga të gjithë.

# 1. Hyrje

Strategjia e Sigurisë Kombëtare është strategjia kryesore mbi sigurinë kombëtare e cila tregon se si një vend i ofron siguri qytetarëve të tij. Të gjitha strategjitë tjera, si strategjia për luftimin e terrorizmit, krimin të organizuar, mbrojtjes, i subordinohen strategjisë kombëtare të sigurisë. Madje, këto strategji duhet të bëjnë të mundur zbatimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Si e tillë, ajo definojnë interesat e vendit të caktuar dhe pozitën e tij në skenën ndërkombëtare, mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë (sfidat, rreziqet, kërcënimet). Pra, Strategjia e Sigurisë Kombëtare është dokument gjithëpërfshirës që trajton aspektet e sigurisë dhe të mbrojtjes së një vendi. Megjithatë, vendet si Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Kina, nuk kanë një dokument të vetëm, por kanë hartuar politika të mbrojtjes apo siç quhen “whitepapers apo livre blanc” që fokusohen më shumë mbi mbrojtjen e vendit.<sup>1</sup>

Krahas përmbajtjes së strategjisë, po aq me rëndësi është edhe procesi deri te formulimi i asaj përmbajtje. Në çdo proces të formulimit të strategjisë së sigurisë kombëtare, një përfshirje sa më e gjerë e institucioneve relevante është e domosdoshme. Sa më gjithëpërfshirës që të jetë procesi i formulimit, aq më shumë konsensus gjendet në mes të akterëve relevant në një strategji të sigurisë. Pastaj, një proces sa më konsensual, aq më i lehtë dhe i koordinuar do të jetë edhe procesi i zbatimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Pa pjesën e zbatimit, Strategjia e Sigurisë Kombëtare do të mbetet një dokument vetëm në letër dhe pa prodhuar efektet për çfarë është hartuar.

Sipas listës së Strategjive dhe Planeve të Veprimit të Qeverisë së Kosovës,<sup>2</sup> Strategjia e Sigurisë e Kosovës është miratuar në Qeveri në qershor 2010<sup>3</sup> e pasuar me Planin e Veprimit për zbatimin e saj të miratuar në korrik 2011.<sup>4</sup> Në këtë mbledhje ishte kërkuar që strategjia të dorëzohet në Kuvend si strategji e jo si projektligj meqë dokumenti në formë të strategjisë do të ndryshohej më lehtë në të ardhmen.<sup>5</sup> Bazuar në të dhënat në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës, kjo strategji nuk gjendet në mesin e dokumenteve

---

<sup>1</sup>DCAF Backgrounder: National Security Policy <http://www.dcaf.ch/Publications/National-Security-Policy>, f.1.

<sup>2</sup>Lista e Strategjive dhe Planeve të Veprimit të Institucioneve të Qeverisë së Kosovës: [http://www.mei-ks.net/repository/docs/Aneksi\\_C\\_-\\_Lista\\_e\\_Strategjive\\_dhe\\_Planeve\\_te\\_Veprimit.pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_C_-_Lista_e_Strategjive_dhe_Planeve_te_Veprimit.pdf)

<sup>3</sup>Vendimi Nr. 01/129 nga mbledhja e Qeverisë e datës 15.06.2010: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_129-te\\_te\\_Qeverise\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_129-te_te_Qeverise_2010.pdf)

<sup>4</sup>Plani i Veprimit i Strategjisë së Sigurisë së Kosovës, Vendimi Nr. 02/24 i datës 20 korrik 2011: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vend.mbl.\\_24-te.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vend.mbl._24-te.pdf)

<sup>5</sup> Në mbledhjen e Qeverisë të datës 15.06.2010 kur u miratua Strategjia e Sigurisë së Kosovës, Ministri i Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi kishte kërkuar që projektligji të dorëzohet në Kuvend si strategji e jo si ligj, për shkak se me ngritjen e kapaciteteve të FSK-së por edhe të institucioneve tjera, strategjia ndryshohet dhe adaptohet me lehtë se sa një ligj: <http://www.zhurnal.mk/content/?id=1561013499>

që janë miratuar në Kuvend, andaj edhe nuk dihet data e miratimit dhe as përmbajtja e saj. Përveç kësaj, procesi i hartimit të këtij dokumenti nuk ka qenë transparent dhe është zhvilluar pa pjesëmarrjen e akterëve tjerë joqeveritar. Si rezultat i RSSS-së dhe ndërrimit të statusit të Forcës së Sigurisë së Kosovës këtë vit, Qeveria e Kosovës do të hartoj një Strategji tjetër të Sigurisë së Kosovës.

Në këtë punim, Forumi për Siguri analizon procesin e hartimit të strategjisë duke e shikuar aspektin e gjithëpërfshirjes, kohëzgjatjes dhe transparencës e debatit publik. Mungesa e këtyre elementeve në hartimin e Strategjisë (ekzistuese) të Sigurisë së Kosovës, dhe qasja që një Strategji e re e Sigurisë të nxjerrët në kuadër të procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS), janë objekt trajtimi në këtë punim. Gjithashtu, Forumi për Siguri adreson procesin e formulimit të strategjisë së sigurisë kombëtare duke shikuar shembuj të suksesshëm të shteteve në këtë proces. Qëllimi i këtij punimi është të shërbej si një dokument diskutimi në mes aktorëve relevant në koordinimin e procesit për hartimin e Strategjisë së re të Sigurisë të Kosovës.

## **2. Strategjia e Sigurisë e Kosovës**

Me hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vije deri te nxjerrja dhe miratimi i një numri të caktuar ligjesh të cilat ishin paraparë edhe me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Një prej këtyre ligjeve ishte ai për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës i miratuar në Kuvend në mars 2008, i cili kishte në mandat edhe nxjerrjen e Strategjisë së Sigurisë së Kosovës.<sup>6</sup> Ky ligj parasheh edhe krijimin e dy organeve mbështetëse të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Sekretariatit dhe Qendrën e Situatave, të cilat më vonë ishin rregulluar me legjislacion sekondar.<sup>7</sup> Sipas pikës 16.4 b) nenit 16 të Ligjit për themelimin e KSK-së, Sekretariati bën koordinimin e hartimit të strategjisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë. Dhe, duke u mbështetur në këtë bazë ligjore, Sekretariati i KSK-së filloi hartimin e Strategjisë së Sigurisë së Kosovës.

Si institucion i ri dhe pa përvojë në koordinimin e hartimit të strategjive dhe politikave të sigurisë, Sekretariati filloi vetë hartimin e Strategjisë së Sigurisë së Kosovës, pa koordinim me institucionet relevante të sigurisë në Kosovë. Mirëpo, përveç që hartimi i saj nuk koordinohet me institucionet relevante të sigurisë në Kosovë, versioni i saj final

---

<sup>6</sup>Ligji 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Neni 2.1 [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L050\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L050_al.pdf)

<sup>7</sup>Ligji 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Kreu III, Neni 16.

nuk kishte kaluar pa ndikime të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë. Më konkretisht, ishte Njësia Këshillëdhënëse për Siguri (Security Advisory Unit) e cila funksiononte në atë kohë në kuadër të zyrës së Zëvendës Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, e cila pas një kohe edhe imponoi versionin final të Strategjisë së Sigurisë së Kosovës. Për më shumë, përveç këtij procesi aspak transparent dhe gjithëpërfshirës deri në finalizimin e saj, strategjia në fjalë nuk është publikuar askund pas miratimit. Sipas listës së Strategjive dhe Planeve të Veprimit të Qeverisë së Kosovës cekur më lartë, e gjithë ajo çfarë dihet sot është se Zyra e Kryeministrit është institucioni përgjegjës në këtë strategji.

Fillimisht, struktura e Këshillit të Sigurisë së Kosovës me organet mbështetëse ishte rekomanduar nga Rishikimi i Brendshëm i Sigurisë në Kosovë (RSBS) i nisur në vitin 2005 dhe përfunduar më 2006.<sup>8</sup> Procesi RSBS ishte iniciuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) i OKB-së, Soren Jesen Petersen, dhe u zhvillua sipas parimeve dhe metodologjisë të dizajnuar nga Grupi Këshillëdhënës për Zhvillimin e Sektorit të Sigurisë. RSBS drejtohej nga Komiteti Drejtues i përbërë nga përfaqësues të lartë të UNMIK-ut, Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë (IPVQ), lider të partive, përfaqësues të komuniteteve dhe Sekretariatit të udhëhequr nga një Koordinator. Sekretariati dhe koordinatori i tij ishin vendosur në Zyrën për Siguri Publike të themeluar në vitin 2004 në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.<sup>9</sup> Në kuadër të kësaj zyre, me vendim të Kryeministrit të atëhershëm, në vjeshtë të vitit 2005 u themelua edhe Qendra e Situatave e cila kishte për mandat informimin e Kryeministrit rreth situatës së sigurisë në Kosovë. Krijimit të saj i parapriu iniciativa nga Njësia Këshillëdhënëse për Siguri e PSSP-së dhe ndihmuar nga Qendra e Situatave që funksiononte në UNMIK. Pastaj, me hartimin e ligjit për themelimin e KSK-së, kjo zyre mund të themi se u zëvendësua me Sekretariatit e KSK-së si organ mbështetës i tij, dhe Qendra e Situatave që ishte në funksionim, kaloi si organ i dytë mbështetës i Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Siç u cek edhe më lartë, sot të dy këto organe mbështetëse funksionojnë në bazë të ligjit për themelimin e KSK-së, dhe legjislacioni sekondar, përkatësisht rregulloreve për funksionimin e tyre.

---

<sup>8</sup>Rishikimi i Sektorit të Brendshëm të Sigurisë, f. 136:

[http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/ISSR\\_report\\_eng\\_ver2.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/ISSR_report_eng_ver2.pdf)

<sup>9</sup>Zyra për Siguri Publike u themelua më 30 qershor 2004 me Urdhëresën Administrative 2004/16:

[http://www.unmikonline.org/regulations/admdirect/2004/ade2004\\_16.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/admdirect/2004/ade2004_16.pdf)

### 3. Strategjia e re e Sigurisë e Kosovës

Për shkak të ndërrimit të statusit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ashtu siç ishte përcaktuar me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës,<sup>10</sup> në prill 2012 Qeveria e Kosovës miratoj vendimin 09/67 për nismën e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS).<sup>11</sup> Ky proces ka kuptimin e rishikimit të sektorit aktual të sigurisë në Kosovë dhe ka përcaktuar 8 faza nëpër të cilat do të kalojë rishikimi. Sipas vendimit në fjalë, procesi do të përfundoj jo më vonë se në qershor të vitit 2013. Megjithatë, duke u bazuar në informatat e paraqitura në mbledhjen e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së ku kishte raportuar ministri i FSK-së, sipas këtij të fundit, vetëm një raport preliminar i këtij procesi do të mund të përgatitet deri në qershor 2012.<sup>12</sup> Pavarësisht kësaj, meqë ky rishikim do të prodhojë efektet në sektorin e sigurisë, praktikisht do të lind nevoja për një strategji tjetër të sigurisë së Kosovës.

Në vazhdim të kësaj analize do të argumentojmë mbi atë se cili institucion në kuadër të arkitekturës institucionale të sektorit të sigurisë në Kosovë duhet ta koordinojë procesin e hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës?

Sipas arkitekturës aktuale të sektorit të sigurisë në Kosovë, përbërjes dhe bazës ligjore, Këshilli i Sigurisë i Kosovës (KSK) është institucioni i vetëm i cili ka kompetencë për hartimin e strategjisë. Kjo për dy arsye: baza ligjore dhe përbërja e tij. Sa i përket bazës ligjore, Këshilli i Sigurisë i Kosovës dhe mandati i tij për ta hartuar strategjinë e sigurisë së pari është referuar nga Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Aneksi VIII, Neni 1.4 *“Kosova do të themelojë Këshillin e Sigurisë së Kosovës (KSK) i cili i raporton Kryeministrit. KSK zhvillon Strategjinë e Sigurisë në përputhshmëri me këtë zgjidhje.”*<sup>13</sup> Në përputhje me këtë dispozitë, Kushtetuta e Kosovës mandaton Këshillin e Sigurisë që *“në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe me Qeverinë, të zhvillojnë Strategjinë e Sigurisë së Republikës së Kosovës”*.<sup>14</sup> Sipas nenit 2.1 të Ligjit për

---

<sup>10</sup> Neni 5, pika 5.3 e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

<sup>11</sup> Vendimi 09/67 i Qeverisë së Kosovës mbi miratimin e nismës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Pika 1.6 e këtij vendimi përcakton nxjerrjen e një strategjie të re të sigurisë, 21.03.2012:

[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_67-te\\_te\\_Qeverise\\_se\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_2012.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_67-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2012.pdf)

<sup>12</sup> Mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, datë 26.03.2013, ku Ministri i FSK-së kishte raportuar për gjendjen tani dhe objektivat e FSK-së gjatë këtij viti.

<sup>13</sup> Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Aneksi VIII, Neni 1.4 [http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal\\_-\\_Propozimi\\_gjith%EBp%EBfshir%EBs\\_-\\_albanian\\_final.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal_-_Propozimi_gjith%EBp%EBfshir%EBs_-_albanian_final.pdf)

<sup>14</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 127, pika 1 <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

themelimin e KSK-së “Këshilli i Sigurisë i Kosovës, në koordinim me Presidentin e Republikës së Kosovës, përgatitë dhe shqyrton Strategjinë e Sigurisë së Kosovës. Strategjia e Sigurisë së Kosovës miratohet nga Qeveria dhe i dorëzohet Kuvendit të Kosovës për miratim përfundimtar”.<sup>15</sup> Bazuar në këtë, pika 1.6 e vendimit 09/67 të Qeverisë së Kosovës mbi nxjerrjen e një Strategjie të re të Sigurisë së Kosovës është në kundërshtim me Nenin 127 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe Nenin 2, pika 2.1 të Ligjit për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Sa i përket përbërjes së tij, KSK ka një përbërje pothuajse ideale për koordinimin e procesit të hartimit të strategjisë së ardhshme të sigurisë së Kosovës, për shkak se mbledhë përfaqësues të institucioneve kyçe në sektorin e sigurisë në Kosovë. Sipas ligjit, KSK ka autoritet dhe një përbërje e cila ndryshon varësisht nga gjendja e sigurisë në Kosovë, gjendje normale dhe të jashtëzakonshme. Në situatë normale, KSK kryesohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga anëtarët permanentë me autoritet ekzekutiv si: Ministri i FSK-së, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Financave, dhe Ministri për Kthim dhe Komunitete. Përveç anëtarëve të përhershëm, në mbledhjet e KSK-së marrin pjesë edhe anëtarë tjerë me karakter të përhershëm por në kapacitet këshillëdhënës si: një përfaqësues i Presidentit, Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, këshilltarin e lartë të Kryeministrit, këshilltarin për siguri të Kryeministrit, Drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Komandantin e FSK-së, Sekretarin e KSK-së, Drejtorin e Doganave, dhe Drejtorin e Agjencisë për Menaxhim Emergjent.<sup>16</sup> Jo me shumë dallime në përbërje, por me rëndësi sa i përket autoritetit, KSK ka autoritet ekzekutiv dhe kryesohet nga Presidenti në situata të jashtëzakonshme.<sup>17</sup> Në përgjithësi, KSK ka rol këshillëdhënës në të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e Kosovës dhe kontributin e saj për stabilitetin rajonal, dhe mblidhet jo më shumë se një herë në katër muaj. Përveç kësaj, KSK ka edhe dy trupa mbështetës, Sekretariatit dhe Qendrën e Situatave.<sup>18</sup>

Duke pasur parasysh autoritetin e KSK-së, i cili gjendet nën ombrellën e Zyrës së Kryeministrit, Këshilli i Sigurisë i Kosovës do të duhej të koordinonte tërë procesin e hartimit të strategjisë së ardhshme të sigurisë së Kosovës. Takimet apo mbledhjet do të udhëhiqeshin nga Kryeministri apo ndonjëri nga zv. Kryeministrat derisa Sekretariati i KSK-së do të koordinonte punën praktike edhe përmes grupeve punuese në emër

---

<sup>15</sup> Neni 2, pika 2.1 e Ligjit 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

<sup>16</sup> Ligji 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Neni 3.

<sup>17</sup> Ligji 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Neni 12 dhe 13.

<sup>18</sup> Ligji 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Neni 16 dhe 17

tëKSK. Megjithatë, bazuar në një organogram<sup>19</sup>të strukturës së organeve mbështetëse të KSK-së, shihet qartë se Sekretariati ka nevojë për një departament i cili obligim kryesor do ta kishte koordinimin në mes të institucioneve dhe agjencive të sektorit të sigurisë në Kosovë. Kjo do të mundësonte krijimin e një sistemi brenda Këshillit të Sigurisë së Kosovës, i cili do të bënte të mundur një koordinim ideal dhe ngjashëm me shumë vende tjera, për hartimin e strategjisë së ardhshme të sigurisë dhe çdo strategjie tjetër e cila kalon kompetencat e një dikasteri të vetëm qeveritar. Institucione të natyrës së njëjtë me Këshillin e Sigurisë së Kosovës funksionojnë edhe në shumë vende ndër të cilat janë: ShBA,<sup>20</sup>Francë, Mbretëri të Bashkuar,<sup>21</sup> Turqi,<sup>22</sup> dhe Kroaci.

#### **4. Disa aspekte me rëndësi për procesin e hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës**

Bazuar në praktikën e vendeve tjera në hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, kjo pjesë do të diskutojë mbi tri aspekte me rëndësi për procesin e hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës: kohëzgjatja, gjithëpërfshirja, transparencja dhe debati publik. Kohëzgjatja e procesit është me rëndësi për faktin se hartimi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare nuk është një proces që duhet të kryhet shpejt, por duhet dizajnuar një proces fleksibil në kohë. Procesi i tillë rezulton me një strategji të qëndrueshme, e cila është formuluar me një përfshirje të gjerë të akterëve të ndryshëm, një proces gjatë të cilit ka pasur komunikim në mes të institucioneve, bashkërendim të aktiviteteve dhe bashkëpunim të mirë deri në finalizimin e saj. Diskutimi i këtyre aspekteve bëhet duke pasur parasysh vendimin 09/67 pikës 1.6 që përcakton nxjerrjen e një strategjie të re të sigurisë së bashku me shtatë objektiva tjera në një periudhë kohore prej një viti, mungesën e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe debatit publik që nuk i ka përfillur procesi i hartimit të strategjisë aktuale të sigurisë, por që duhet gjithsesi t'i adresoj procesi i hartimit të strategjisë së ardhshme të sigurisë së Kosovës.

---

<sup>19</sup> Aneksi 1.51 i Përgjigjeve në Pyetësorin për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit: [http://www.mei-ks.net/repository/docs/Aneksi\\_1.51\\_-\\_Keshilli\\_i\\_Sigurise\\_se\\_Kosoves.pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_1.51_-_Keshilli_i_Sigurise_se_Kosoves.pdf)

<sup>20</sup> Këshilli i Sigurisë Kombëtare në ShBA: <http://www.whitehouse.gov/administration/eop/nsc>

<sup>21</sup> Këshilli i Sigurisë Kombëtare në Mbretëri të Bashkuar:

<https://www.gov.uk/government/organisations/national-security/groups/national-security-council>

<sup>22</sup>Këshilli i Sigurisë Kombëtare në Turqi: <http://www.mgk.gov.tr/>

## 4.1. Kohëzgjatja

Përveç të qenit në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin për themelimin e KSK-së, vendimi i lartcekur për procesin e RSSS, është jo funksional edhe sa i përket kohës së hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës. Sipas këtij vendimi, në mesin e tetë objektivave, një prej tyre është edhe hartimi i strategjisë, ndërsa koha e kryerjes të tetë objektivave është Mars 2012-Qershor 2013. Përveç objektivës 1.6 për nxjerrjen e një Strategjie të re të Sigurisë, objektivat tjera janë mjaft madhore dhe kërkojnë kohë. Definimi i objektivave strategjike, politikat e sigurisë dhe të mbrojtjes, definimi i ambientit strategjik të Kosovës, rreziqet, kërcënimet, të bëhet analizë e plotë e kapaciteteve aktuale të institucioneve të sigurisë, janë vetëm disa prej këtyre objektivave. Të gjitha këto kërkojnë kohë të mjaftueshme që të kryhen mirë dhe me profesionalizëm. Shikuar edhe nga aspekti kohor, hartimi i Strategjisë së Sigurisë, në kuadër të këtyre objektivave, nuk do të duhej të ishte pjesë e këtij vendimi.

Sa i përket praktikave të vendeve tjera se sa kohë kanë bërë për të shkruar një Strategji të mirë të Sigurisë Kombëtare, vërehet se nuk ka një standard kohor i cili do të duhej të aplikohet edhe në Kosovë. Por, një proces i shkurt në kohë ka pak mundësi që të prodhojë një strategji të mirë. P.sh. Qeveria e Britanisë së Madhe ishte kritikuar masivisht nga një numër i madh i njerëzve sepse kishte draftuar një dokument 75 faqesh mbi Rishikimin Strategjik të Sigurisë dhe Mbrojtjes në më pak se pesë muaj kohë, derisa një dokument 11 faqesh mbi Konceptin Strategjik të NATO-s ishte hartuar përgjatë një viti.<sup>23</sup> Mirëpo, e gjithë ajo çfarë mund të shërbejë në rastin e Kosovës është që procesi i hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë e Kosovës duhet të jetë fleksibil në kohë, në kuptimin që të ketë kohë të mjaftueshme për një draftim shumë të mirë të saj. Pra, kjo strategji nuk duhet shkruar shpejt e shpejt vetëm sa për të pasur një strategji të sigurisë në nivel vendi, por draftimi i saj kërkon kohë, bashkërendim të mirë në mes të institucioneve relevante, dhe komunikim e bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha palët e përfshira në proces.<sup>24</sup>

---

<sup>23</sup>Jonas, A. "Mind the Process": [http://archive.atlantic-community.org/index/articles/view/Mind\\_the\\_Process](http://archive.atlantic-community.org/index/articles/view/Mind_the_Process)

<sup>24</sup>Komunikimi bashkërendimi dhe bashkëpunimi janë shumë me rëndësi për procesin e draftimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Këto në gjuhë angleze zakonisht njihen si tri "C" - duke nënkuptuar fjalët: Communication, Coordination, Cooperation.

## 4.2. Gjithëpërfshirja

Gjithëpërfshirja në procesin e formulimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare është mënyra më e mirë për të adresuar sfidat dhe brengat e sigurisë nga të gjithë palët në nivel vendi. Po ashtu, inputet nga organizatat joqeveritare duhet të merren parasysh dhe të adresohen.<sup>25</sup> Kësisoj, Strategjia e re e Sigurisë e Kosovës nuk duhet lënë vetëm një apo dy institucioneve që ta shkruajnë atë, përkundrazi, procesi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të ketë institucione nga të tri degët e pushtetit në Kosovë, organizata të shoqërisë civile, pjesa akademike në fushën e sigurisë, dhe të tjerë që gjatë procesit mund të kontribuojnë. Një gjithëpërfshirje do të eliminonte mundësinë që strategjia në fjalë të ishte vetëm e një apo dy institucioneve të sektorit të sigurisë, por e gjithë sektorit si Strategji e Sigurisë e Kosovës. Pastaj, përfshirja e partive politike në këtë proces ku ato gjatë gjithë kohës do të kontribuonin në proces, e lehtëson edhe procesin e miratimit të strategjisë në Kuvend.

Kontributi i “think-tank” në formulimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare është shumë i vlerësueshëm dhe me rëndësi. P.sh. në ShBA roli i tyre në formulimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare ka qenë shumë me rëndësi për procesin gjatë formulimit të strategjisë në vitin 1994. Shumë nga çështjet që ishin adresuar me strategjinë e draftuar më 1994, më herët ishin diskutuar gjerësisht dhe publikuar nga disa “think-tank” në ShBA.<sup>26</sup> Kjo praktikë e përfshirjes së “think-tank” në ShBA ka vazhduar dhe është zgjeruar gjatë gjithë periudhave të hartimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare në ShBA. Shembull të mirë të përfshirjes së “think-tank” përfaqëson edhe Franca ku në rastin e fundit të hartimit të strategjisë<sup>27</sup> një “think-tank” i njohur në Francë kishte qenë pjesë e Këshillit i cili bënte hartimin e këtij dokumenti.

## 4.3. Transparenca dhe debati publik

E lidhur ngushtë me procesin e përfshirjes së akterëve të ndryshëm në procesin e hartimit të strategjisë, është transparenca e procesit dhe debati publik. Një proces transparent i formulimit ndihmon për të parandaluar edhe interesat e ministrive

---

<sup>25</sup>DCAF Backgrounder: National Security Policy <http://www.dcaf.ch/Publications/National-Security-Policy>, f. 4.

<sup>26</sup> Think Tanks and the National Security Strategy formulation process: a comparison of current American and French patterns, f. 10 <http://www.dau.mil/pubscats/PubsCats/AR%20Journal/arq97/ranque.pdf>

<sup>27</sup>Apo siç quhet në Francë “*Livre blanc sur la défense et la sécurité nationale*” (Libër i bardhë mbi mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare).

individuale apo agjensioneve të sigurisë, nga dominimi i produktit final.<sup>28</sup>Zvicra aplikon një shembull të mirë debati të gjerë social e politik dhe pastaj fillon draftimi i dokumentit në fjalë nga ana e Qeverisë. Ky proces ka një qasje të dy-anshme: së pari lansohet një proces i gjerë dhe gjithëpërfshirës konsultimi i cili përmbillet me draftimin e një raporti me sygjerime për Qeverinë, e pastaj draftimi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare nga ana e Qeverisë.<sup>29</sup> Debat publik mund të bëhet përmes mjeteve, si forumet në internet dhe mbulueshmërisë në media. Një proces i tillë mundëson krijimin e besimit në mes të shoqërisë dhe shtetit sidomos kur është fjala për hartimin e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes në nivel vendi. Fundja, strategjitë dhe politikat e sigurisë të çdo vendi hartohen si mjete përmes të cilave shteti tregon se si i ofron siguri qytetarëve të vet, andaj për të pasur një pranueshmëri dhe legjitimitet tek qytetari, hartimi i tyre duhet të jetë shumë transparent.

Përveç kësaj, në rastin me Strategjinë e Sigurisë së Kosovës, transparencja ka dy aspekte: i pari lidhet me të qenit transparent gjatë hartimit të strategjisë, dhe i dyti lidhet me bërjen publike të dokumentit final të strategjisë pas miratimit.

## **5. A duhet të bëhet publike Strategjia e Sigurisë Kombëtare?**

Sipas Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, strategjia e sigurisë kombëtare nuk bie në ndonjë nga nivelit e klasifikimit të informacioneve.<sup>30</sup>

Bazuar në praktikën e vendeve të rajonit dhe ato të BE-së, vërehet se shumica e këtyre shteteve bëjnë publike qoftë Strategjinë e Sigurisë Kombëtare qoftë një dokument tjetër të karakterit kombëtar të sigurisë dhe mbrojtjes.

---

<sup>28</sup>DCAF Backgrounder: National Security Policy <http://www.dcaf.ch/Publications/National-Security-Policy>, f. 4.

<sup>29</sup>DCAF Backgrounder: National Security Policy <http://www.dcaf.ch/Publications/National-Security-Policy>, f. 3.

<sup>30</sup>Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, Neni 4. <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-178-alb.pdf>

**Tabela nr. 1 - Vendet që kanë bërë publike strategjitë e sigurisë kombëtare apo dokument tjetër relevant për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare<sup>31</sup>**

| <b>Nr.</b>                | <b>Vendi</b>           | <b>Dokumenti</b>   | <b>Viti</b> |
|---------------------------|------------------------|--|-------------|
| 1                         | Austria                | Doktrina e Sigurisë dhe Mbrojtjes                                    | 2002        |
| 2                         | Belgjika               | Plani i modernizimit të forcave të armatosura të Belgjikës 2000-2015 | x           |
| 3                         | Bullgaria              | Strategjia Kombëtare e Sigurisë                                      | 2011        |
| 4                         | Qipro                  | x  | x           |
| 5                         | Republika Çeke         | Strategjia e Sigurisë e Republikës Çeke                              | 2011        |
| 6                         | Danimarka              | Mbrojtja Daneze - angazhimi global                                   | 2008        |
| 7                         | Estonia                | Koncepti i Sigurisë Kombëtare  | 2004        |
| 8                         | Finlanda               | Politika e mbrojtjes dhe sigurisë                                    | 2009        |
| 9                         | Franca                 | Letër e bardhë mbi mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare                  | 2008        |
| 10                        | Gjermania              | Letër e bardhë mbi politikat e sigurisë dhe të ardhmen e vendit      | 2006        |
| 11                        | Greqia                 | Letër e bardhë mbi forcat e armatosura                               | 1997        |
| 12                        | Hungaria               | Strategjia Kombëtare e Sigurisë                                      | 2004        |
| 13                        | Irlanda                | Deklaratë e strategjisë  | 2008        |
| 14                        | Italia                 | Koncept strategjik   | x           |
| 15                        | Letonia                | Koncepti i Sigurisë Kombëtare  | 2005        |
| 16                        | Lituania               | Strategjia Kombëtare e Sigurisë                                      | 2005        |
| 17                        | Luksemburgu            | x  | x           |
| 18                        | Malta                  | x  | x           |
| 19                        | Holanda                | Strategjia e Sigurisë Kombëtare                                      | 2007        |
| 20                        | Polonia                | Strategjia Kombëtare e Sigurisë                                      | 2007        |
| 21                        | Portugalia             | Dokument mbi mbrojtjen kombëtare                                     | 2001        |
| 22                        | Rumania                | Strategjia Kombëtare e Sigurisë                                      | 2005        |
| 23                        | Sllovakia              | Strategjia e Sigurisë e Republikës së Sllovakisë                     | 2005        |
| 24                        | Sllovenia              | Strategjia Kombëtare e Sigurisë                                      | 2001        |
| 25                        | Spanja                 | Strategjia e Sigurisë e Spanjës                                      | 2011        |
| 26                        | Suedia                 | x  | x           |
| 27                        | Mbretëria e Bashkuar   | Strategjia Kombëtare e Sigurisë                                      | 2010        |
| <b>Vendet e regjionit</b> |                        |  |             |
| 28                        | Shqipëria              | Strategjia e Sigurisë Kombëtare                                      | x           |
| 29                        | Bosnja dhe Hercegovina | Letër e bardhë mbi mbrojtjen   | 2005        |
| 30                        | Kroacia                | Dokument mbi mbrojtjen   | 2005        |
| 31                        | Kosova                 | x  | x           |
| 31                        | Magedonia              | Letër e bardhë mbi mbrojtjen   | 2012        |
| 32                        | Mali i Zi              | Strategjia e Sigurisë Kombëtare                                      | 2006        |
| 33                        | Serbia                 | Strategjia e Sigurisë Kombëtare                                      | 2009        |

<sup>31</sup> Emrat e dokumenteve janë përkthyer në gjuhën shqipe për të qenë më lehtë të lexueshëm për publikun e gjerë. Viti është marrë nga dokumenti përkatës.

## 6. Shembuj praktik të konsultimeve gjithëpërfshirëse në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë

Meqenëse çdo shtet vepron në kuadër të rrethanave dhe një konteksti specifik, nuk ka një model që do të shërbente si “procesi më i mirë” që duhet aplikuar për hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare.<sup>32</sup> Megjithatë, më poshtë do të diskutohen dy shembuj të mirë të konsultimeve gjithëpërfshirëse dhe transparente në hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare.

### 6.1. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA)

Një proces koordinimi në mes të akterëve në draftimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare në ShBA e mundëson Këshilli i Sigurisë Kombëtare. Ky institucion është themeluar në vitin 1947 përmes një Akti të quajtur Akti i Sigurisë Kombëtare.<sup>33</sup> Bazuar në këtë akt, roli i Këshillit të Sigurisë Kombëtare është të këshillojë Presidentin në politika të sigurisë kombëtare. Anëtarët e tij statusor janë: Presidenti i cili e drejton këtë institucion, zv. Presidenti, Sekretari i Shtetit, i Mbrojtjes dhe i Energjisë, Shefi i stafit dhe Drejtori i Agjencisë Qendrore të Inteligjencës.<sup>34</sup> Ndërsa, në procesin e hartimit të politikave, edhe të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, departamentet kyçe në këtë proces janë: Departamenti i Shtetit, Departamenti i Mbrojtjes, komuniteti i inteligjencës, dhe Departamenti i Sigurisë Vendore (atdheut). Përveç kësaj, Kongresi, “think-tank” organizatat, grupet e interesit dhe media janë shumë të përfshira në komunitetin e sigurisë kombëtare dhe rrjedhimisht kanë ndikim në hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare.

Duke u nisur edhe nga praktikat e vendeve tjera, ShBA është vendi i cili ndjek një proces gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Roli i Këshillit të Sigurisë Kombëtare është qendror në këtë aspekt duke ofruar një vend për koordinimin e mirë e të gjithë aktorëve relevant në këtë proces dhe në tërë ciklin e përgatitjes së politikave të sigurisë. Përveç kësaj, rëndësi të madhe në këtë proces kanë edhe “think-tank” organizatat e ndryshme të specializuara në fushën e sigurisë

---

<sup>32</sup> Jonas, A. “Strategy processes: opportunities, challenges and traps”  
f.2 <http://www.euglobalstrategy.eu/nyheter/opinions/strategy-processes-opportunities-challenges-and-traps>

<sup>33</sup> National Security Act of 1947: <http://www.intelligence.senate.gov/nsaact1947.pdf>

<sup>34</sup> G. Whittaker, A., Shannon A. Brown, Frederick C. Smith and Ambassador Elizabeth McKune: The National Security Policy Process: the National Security Council and Interagency Process  
<http://www.ndu.edu/es/outreach/publications/nspp/docs/icaf-nsc-policy-process-report-08-2011.pdf>,  
f.12.

kombëtare, dhe palët apo grupet e interesit. Përveç në aspekte tjera, edhe aspekti i hartimit të strategjisë së sigurisë kombëtare në ShBA mund të cilësohet si mjaft transparent dhe i përcjellë me një debat të gjerë publik lidhur me interesat e vendit, ambientin strategjik, dhe rreziqet e kërcënimit e vlerësuara për këtë vend. ShBA shërben si shembull i mirë në këtë aspekt edhe për shumë vende tjera të zhvilluara në Evropë.

## 6.2. Franca

Franca përfaqëson një shembull të një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e “Libër i bardhë mbi sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare” (“*Livre blanc sur la défense et la sécurité nationale*”).<sup>35</sup> Në vitin 2007, Presidenti i Francës kishte themeluar një Komision të posaçëm në hartimin e këtij dokumenti ku përveç përfaqësuesve të institucioneve relevante qeveritare, parlamentarë dhe individë të kualifikuar nga pjesa akademike, nga think-tank<sup>36</sup> dhe ekspertë të pavarur kishin marrë pjesë në këtë proces.<sup>37</sup> Për dallim nga proceset paraprake, Komisioni kishte organizuar debate televizive me mbulueshmëri të gjerë dhe dëgjime “online” të 52 personaliteteve nga 14 vende të ndryshme.<sup>38</sup> Përveç kësaj, Komisioni në fjalë kishte krijuar edhe një faqe zyrtare ku të interesuarit kanë dërguar sygjerimet dhe propozimet e tyre mbi pika të caktuara të dokumentit në fjalë. Dokumenti i tillë i cili u përditësua në Francë gjatë 2007-2008 ishte shkruar në vitin 1994. Realiteti më 1994 ishte ndryshe dhe ky dokument ishte bazuar në një mjedis të sigurisë kryesisht i dalë nga koha e Luftës së Ftohtë. Si i tillë, ky dokument nuk ishte në gjendje të adresonte sfidat e sigurisë të dala me procesin e globalizimit dhe sfidave tjera të sigurisë që ndikojnë atë. Prandaj, dokumenti ishte përditësuar gjatë 2007-2008 dhe është dizajnuar në atë mënyrë që të jetë relevant për 15 vitet e ardhshme.<sup>39</sup> Në bazë të kësaj, nëse nuk ka ndonjë ndryshim të papritur, Franca ka një dokument bashkëkohor mbi mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, i cili do të jetë konsistent me sfidat e kohës deri në vitin 2023.

---

<sup>35</sup> The French White paper on defense and national security: [http://www.ambafrance-ca.org/IMG/pdf/Livre\\_blanc\\_Press\\_kit\\_english\\_version.pdf](http://www.ambafrance-ca.org/IMG/pdf/Livre_blanc_Press_kit_english_version.pdf)

<sup>36</sup> Njëri nga anëtarët e Komisionit ishte Drejtor i një think-tank në Francë, French Institute for International Relations.

<sup>37</sup> GCSP Geneva Paper 9, Security Strategies today: trends and perspectives, f. 13 <http://www.gcsp.ch/Resources-Publications/Publications/GCSP-Publications/Geneva-Papers/Conference-Series/Security-Strategies-Today-Trends-and-Perspectives>

<sup>38</sup> The French White Paper on Defense and National Security, f. 3

<sup>39</sup> GCSP Geneva Paper 9, Security Strategies today: trends and perspectives, f. 12.

## Përfundime dhe rekomandime

Siç u diskutua më lartë, procesi i hartimit të strategjisë së ardhshme të sigurisë së Kosovës duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe transparent dhe përveç institucioneve publike, duhet të përfshihen shoqëria civile, mediat, ekspertë ta pavarur dhe palë tjera të interesuara. Bazuar në arkitekturën institucionale të sektorit të sigurisë në Kosovë dhe bazën ligjore, Këshilli i Sigurisë i Kosovës (KSK) është institucioni i cili duhet të koordinojë procesin për hartimin e kësaj strategjie i cili do të mbështetej në parimin e gjithëpërfshirjes, komunikimit, bashkërendimit, dhe bashkëpunimit me të gjitha akterët publik dhe jopublik relevant në hartimin e strategjisë së ardhshme të sigurisë së Kosovës. Një proces i tillë do të mundësonte që i tërë procesi i hartimit të jetë transparent dhe do të lehtësonte pjesën e zbatimit të strategjisë. Nëse do të kishte përfshirje të gjerë të të gjithë aktorëve relevant, do të ndërtohej konsensus mbi përmbajtjen e strategjisë, dhe kjo do të lehtësonte edhe zbatimin e saj.

Po ashtu, shumica e vendeve të rajonit dhe të Bashkimit Evropian kanë publikuar qoftë strategjinë e sigurisë kombëtare, qoftë dokument tjetër relevant në sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare. Nëse strategjia e ardhshme e sigurisë e Kosovës do të kishte informacion apo të dhëna konfidenciale, këto do të duhej të liheshin pjesë e strategjive tjera dhe mos të ndikojnë që strategjia e sigurisë të jetë konfidenciale. Vetëm vendet jo demokratike në botë nuk bëjnë publike një strategji të tillë. Në mesin e shembujve të suksesshëm, ShBA dhe Franca janë dy vende që kanë ndjekur një proces gjithëpërfshirës, transparent dhe kanë bërë të mundur debate publike në drejtim të formulimit të strategjisë së sigurisë kombëtare.

Bazuar në diskutimin dhe përfundimet më lartë, Forumi për Siguri rekomandon marrjen e këtyre hapave:

- Hartimi i Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës nuk duhet të jetë pjesë e vendimit 09/67 mbi lansimin e nismës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS);
- Për të pasur kohezion në mes të procesit të RSSS-së dhe formulimit të strategjisë, Qeveria duhet të nxjerrë vendim për hartimin e strategjisë pas përfundimit të procesit të RSSS-së;
- Sipas Kushtetutës dhe Ligjit për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK), vendimi i Qeverisë për formulimin e strategjisë në fjalë duhet të caktojë KSK-në si institucionin e duhur për koordinimin e procesit të formulimit të strategjisë së re të sigurisë së Kosovës;

- Të sigurohet një proces gjithëpërfshirës dhe transparent ku shoqëria civile, ekspertë të pavarur, media dhe të tjerë të interesuar, të marrin pjesë nga fillimi në proces;
- Këshilli i Sigurisë i Kosovës duhet të caktoj një zyrtar në kuadër të Sekretariatit të KSK-së që do të kishte përgjegjësinë e koordinimit të tërë procesit;
- Në fund të procesit, Qeveria duhet të publikojë Strategjinë e Sigurisë së Kosovës në mënyrë që të jetë e qasshme për publikun në Kosovë dhe më gjerë;

# FORUMI për SIGURI

Forumi për Siguri është themeluar nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) në partneritet me Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) në qershor të vitit 2010, me mbështetjen e organizatës britanike Saferworld, në kuadër të programit “Vendi i Sigurt”, financuar nga qeveria gjermane dhe britanike. Puna e FS mbështetet financiarisht edhe nga Balkan Trust for Democracy (BTD).

Forumi për Siguri përbëhet nga:

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), Instituti për Studime të Avancuara GAP, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (KLI).

Forumi për Siguri synon të kontribuoj për të përmirësuar mjedisin e sigurisë, duke promovuar institucione dhe politika efektive. Forumi për Siguri shërben si një platformë diskutimi midis organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve në Kosovë, dhe ofron mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe mësimëve mbi sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare. Forumi për Siguri sjellë së bashku aktorët kryesorë të sigurisë dhe të drejtësisë, si dhe sektorët tjerë relevant me një ndikim mbi sigurinë, dhe avokon për të ndikuar në zhvillimin e politikave.